



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 63

Prishtinë, më 5.4.2012, ora 9,35

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Munguan : Liburn Aliu, Salih Morina, Afërdita Berisha-Shaqiri,

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: USAID.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 2.4.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndërtim, në parim,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.4.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 2.4.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndërtim

Kryetari Nait Hasani në paraqitjen e shkurt arsyetoi mbajtjen e mbledhjes urgjente për shkak të interesimit të ndërkombëtarëve që janë të interesuar të kontribuojnë në këtë projektligj, si dhe arsyeve të krijuara gjatë mbajtjes së dy takimeve të komisionit me propozuesin e ligjit dhe

ekspertët ndërkombëtar. **Nijazi Idrizi** tha se gjatë pranimi të vërejtjeve të deritashme ka krijuar bindjen se shumëkush nuk është ftuar në debate gjatë hartimit të ligjit, mirëpo pas takimeve të mbajtura të komisionit ka krijuar bindjen që megjithatë mund të rregullohet projektligji në procedurën e shqyrtimit në Komision. **Daut Haradinaj** nuk kundërshtoi miratimin në parim të projektit por kundërshtoi procedurat e shpejtuara, ndaj për hera tjera insistoi të respektohen rregullat. Komisioni unanimisht nxori :

P Ë R F U N D I M

Miratohet në parim, Projektligji për ndërtim.

Mbledhja përfundoi në orën 9,50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani